

VENDIM
Nr. 366, datë 26.4.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA KOMISIONERI PËR TË
DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE,
MINISTRISËSË ZHVILLIMIT URBAN, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË
ZYRAVE NË KATIN E PESTË TË GODINËS SË ISH-SHTËPISË BOTUESE “NAIM
FRASHËRI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Entin Kombëtar të Banesave, të zyrave në katin e pestë të godinës së ish-shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban, Entit Kombëtar të Banesave u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Zhvillimit Urban, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi